



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:226421

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05653156

**P.nr..../...**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit B... I... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.2163/22 të datës 01.11.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 03.05.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.../... e datës ....., lidhur në mes të pandehurit B... I.... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.... sh.a në P....

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.2163/22 të datës 01.11.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit B... I..., i lindur më ....në P..., me vendbanim në Rr “..... nr....” në P..., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. .... posedues i nr. te telefonit ....., i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 01.11.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.2163/22 ndaj të pandehurit Besim Idrizi për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën ..... është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit B... I.... dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.... sh.a në P..., me nr, Nd.nr..../... e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../. e datës ....., lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.... sh.a në P....

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2022:226421, 03.05.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gjyqtari**

\_\_\_\_\_  
Edona Berisha Kastrati

\_\_\_\_\_  
Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi